



**Datë:** 07.07.2025  
**Numër Protokolli:** 4781/2025

**A.nr.603/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.603/2025, të datës 04.04.2025, të parashtruar nga ankuesja M.D-K, kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.07.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.603/2025, e datës 04.04.2025, e parashtruar nga ankuesja M.D-K.

**II. Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 03.02.2025, me numër reference RN00016596, për Grupin e Arkivave, për pozitën “*Zyrtar për Arkiv*”, i shpallur nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe çdo veprim procedural që rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

**III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë, të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, M.D-K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 04.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e pranimi sipas konkursit me reference RN00016596, për grupin e Arkivave, për pozitën “*Zyrtar për Arkiv*” i shpallur nga Ministria e Shëndetësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 14.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 18.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2249/2025 të parashtruar nga ankuesja më datë 04.04.2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë të Ministrisë së Shëndetësisë, të datës 18.04.2025, Konkursi me numër reference RN00016596, për grupin e Arkivave, për pozitën “Zyrtar për Arkiv”, i shpallur me datë 03.02.2025, nga Ministria e Shëndetësisë; Kërkesën e aprovuar për iniciimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Zyrtar për Arkiv të datës 15.01.2025; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe Listën e kandidatëve të refuzuar, Vendimin për formimin e komisionit të pranimit të kategorisë profesionale për pozitën e punës Zyrtar për Arkiv; Akt emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Njoftimin për shpalljen e rezultateve përfundimtare; Aplikacionin e ankueses së bashku me dosjen; Aplikacionin e kandidatës fituese së bashku me dosjen; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga Komisioni i Pranimit, Testimin elektronik të ankueses dhe kandidatës fituese; Rezultatin e testit me shkrim; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatët në intervistë dhe Testin individual me përgjigjeje të ankueses dhe kandidatës fituese.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Ministria e Shëndetësisë, më datë 03.02.2025, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00016596, për grupin e Arkivave, për pozitën “Zyrtar për Arkiv” Profesional 3 me koeficient të pagës 5.2, me afat të aplikimit nga data 04.02.2025 deri më 05.03.2025.

Tutje, nga provat e çështjes në vendosje, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej nëntëdhjetatë (97) kandidatë, përfshirë ankuesen, ndërsa sipas listës së ngushtë vetëm tridhjetenjë (31) nga kandidatët, në mesin e të cilëve edhe ankuesja, kanë plotësuar kushtet për vazhdim në testin me shkrim ku kanë marr pjesë pesëmbëdhjeta (15) kandidatët, ku vetëm tre (3) kandidatë kanë kaluar testin me shkrim, ndërsa ankuesja është renditur e teta (3) me 43.4 pikë të fituara në testin me shkrim, të pa mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistës me gojë.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, me datë 28.03.2025, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare ku rezulton se kandidatja B.K ka marr numrin me të madh të pikëve gjithsej 89.2.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ka pasur manipulime në rezultatin e testimit me shkrim për qëllime të caktuara sepse është e pamundur që rezultatin e saj prej 43.4 pikë dhe mos të arrij të ftohet në intervistë nga komisioni, më qëllim të favorizimit të kandidatës fituese B.K.

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit sipas Konkursit me numër reference RN00016596, për grupin e Arkivave, për pozitën “Zyrtar për Arkiv” Profesional 3 me koeficient të pagës 5.2, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se, organi përkatës i punësimit, si kritere të përgjithshme formale, në konkursin përkatës të punës ka vendosur: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë/a e arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor). Në Arkivë, Administratë Publike, Histori ose Juridik; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën për të cilën është përgjegjëse kjo pozitë.*

Kolegji i Këshillit, përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit, mori për bazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës I të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës VI të dispozitivit të të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 03.02.2025 pra pas hyrjes në fuqi të Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil.

Duke marrë për bazë Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, të aprovuar sipas Vendimit Nr.08/226 të datës 23.10.2024, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita “Zyrtar për Arkiv” identifikohet me kodin SHC-1043 në kuadër të grupimit Grupi i Arkiv-Dokumentacionit, kurse fusha e kërkuar e arsimit është e përcaktuar sikurse sipas Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil gjegjësisht është e përcaktuar: *Diplome Universitare nga Fakulteti Juridik/Histori/Letërsi/Arkivistikë/Orientalistikë, Antropologji, Ballkanistikë.*

Kolegji i Këshillit, po ashtu konstaton faktin se Ministria e Shëndetësisë e ka të aprovuar edhe Rregulloren (ZKM) Nr. 15/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila është në fuqi nga data 28.06.2024, ku sipas kësaj rregulloreje pozita „Zyrtar për Arkiv” është përcaktuar në kategorinë dhe klasën Profesionale 2, ndërsa te grupi i pozitave, pozita e lartpërmendur është vendosur tek Grupi i Arkiv-Dokumentacionit, andaj kategorizimi i klasës në “Profesional 3” për pozitën Zyrtar për Arkiv dhe grupimi në Grupin e Arkivave sipas konkursit me nr. RN00016596, është në kundërshtim edhe me këtë rregullore.

Në këtë kuptim, duke u bazuar në dispozitat e aplikuara të nenit 19, nenit 20 si dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: **“19. Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi; 20.1 . Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 20.2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për pozitën përkatëse. 30.1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 30.2. Katalogu i vendeve të punës**

***përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.***”, .”, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Shëndetësisë , shpalljen e konkursit me numër reference RN00016596 të datës 03.02.2025 kategoria profesional 3 për pozitën „ Zyrtar për Arkiva ” e ka shpallur në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar dhe i cili ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024 sipas Vendimit Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërlidhur me Shtojcën Nr.2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, pasi që pozita në fjalë „Zyrtar për Arkive ” hynë në kuadër të grupimit ***Grupi i Arkiv-Dokumentacionit***., ndërsa sipas konkursit pozita në fjalë është përfshirë në Grupin e Arkivave respektivisht grupin me Nr. 53, ku fusha e kërkuar e arsimit është përcaktuar: *Arkivë, Histori, Histori e Artit, Antropologji, Orientalistikë, Ballkanistikë dhe nën-specializime të konservimit*, kurse organi i punësimit në këtë rast Ministria e Shëndetësisë, në aktin e shpalljes së konkursit me numër reference RN00016596, për grupin e Arkivave, për pozitën “Zyrtar për Arkiv” Profesional 3 me koeficient të pagës 5.2”, si fushë të studimit ka vendosur vetëm fushën e studimit në *Arkivë, Administratë Publike, Histori ose Juridik*, pra, përcaktimi i kriterëve të konkursit në kuptim të fushës se studimeve është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht pozitës në fjalë i janë shtuar edhe kriteret tjera të fushës së studimit, në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Kasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe krejt në fund i është ndryshuar grupimi dhe i janë ndryshuar kriteret e përcaktuara të kualifikimit arsimor të cilat janë të përcaktuara sipas rregullores së lartcekur, Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, dhe Rregullores (ZKM) Nr. 15/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Shëndetësisë, nga rrjedh se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me nenin 19 dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Gjithashtu në klasifikimin e pozitës dhe koeficientit të pagës sipas konkursit me numër reference RN00016596, për grupin e Arkivave, për pozitën “Zyrtar për Arkiv” Profesional 3 me koeficient të pagës 5.2” ka mospërputhje në raport të klasës së pozitës me koeficientin e përcaktuar, që bie në kundërshtim nenin 14 paragrafit 2 të Ligjit NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku përcaktohet se : „*Paga bazë e nëpunëses/it civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcën Nr. 10 të këtij ligji*”, ku konkretisht në shtojca nr. 10.6.- ministri, agjenci të pavarura, agjenci rregullatore, agjenci ekzekutiv dhe të shërbimit publik në numrin rendor 21 për emërtimin e pozitës Profesional 3, është paraparë klasa I16 koeficienti i pagës 4.1 e jo siç është përcaktuar në konkurs koeficienti 5.2, ky koeficient është i përcaktuar për emërtimin e pozitës profesional 2 klasa I14, në shtojcën Nr. 10.6 numri rendor 19 të Ligjit NR. 08/L-196196 për Pagat në Sektorin Publik, duke vepruar kështu në kundërshtim edhe me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht Shtojcën Nr.1/7: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 3, ngase tek kërkesat e përgjithshme kërkohet diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente kurse përvoja e punës e kërkuar tek kjo klase nuk kërkohet fare përvojë pune.

Kolegji i Këshillit, po ashtu analizoi edhe përbërjen Komisionit përkatës për vlerësimin profesional të kandidatëve për praninë në shërbim civil, nga analizimi i së cilave shkresa ka gjetur se kandidatët pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit me numër Reference RN00016596, për pozitën “Zyrtar për Arkiv” në Ministrinë e Shëndetësisë janë vlerësuar nga Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit Nr.148/III/2025 të datës 13.03.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili vlerësim më konkretisht është realizuar nga kjo përbërje e Komisionit të Pranimit: A.I, kryesuese, e cila sipas akt emërimit të datës 23.12.2024, e njëjta ka

themeluar marrëdhënien e punës më datë 23.12.2024, pranë organit përkatës të punësimit pas përfundimit të procedurës së rekrutimit me numër RN00015243 të datës 21.11.2024 dhe atë në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Teknologji Informative dhe Arkiv, ashtu që konstatohet se e njëjti që nga data e themelimit të marrëdhënies së punës apo nënshkrimit të Akt emërimit përkatës është ende në periudhën provuese, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve; - T.A, anëtar, i cili sipas akt emërimit të datës 23.12.2024, i njëjti mbanë pozitën Udhëheqëse i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme dhe Logjistike në Ministrinë e Shëndetësisë; H.B, anëtare, e cila sipas Akt emërimit të datës 23.12.2024, e njëjta mbanë pozitën Zyrtare për Logjistike në Ministrinë e Shëndetësisë; A.M.Rr anëtare, e cila sipas Akt emërimit të datës 23.12.2024, e njëjta mbanë pozitën Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë ; V.K, anëtare, e cila sipas akt emërimit të datës 23.12.2024, e njëjta ka themeluar marrëdhënien e punës më datë 23.12.2024, pranë organit përkatës të punësimit pas përfundimit të procedurës së rekrutimit me numër RN00015192 të datës 19.11.2024 dhe atë në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet, ashtu që konstatohet se e njëjti që nga data e themelimit të marrëdhënies së punës apo nënshkrimit të Akt emërimit përkatës është ende në periudhën provuese, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve; Andaj, referuar gjetjes si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se përbërja e Komisionit të Pranimit për vlerësimin profesional të kandidatëve për pozitën e punës *Zyrtar për Arkiv*, rrjedhimisht në rastin konkret me caktimin e nëpunëses civile A.I në cilësinë e kryesueses dhe në V. K. në cilësinë e anëtares të Komisionit të Pranimit, sipas Vendimit Nr.148/III/2025 të datës 13.03.2025, organi përkatës i punësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 51 paragrafin 1 dhe 3, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *1. Nëpunësja/i civil që emërohet për herë të parë në pozitë të kategorisë profesionale apo të specialistes/it në shërbimin civil, apo që merr mandatin sipas nenit 46 dhe 49 të këtij ligji, i nënshtrohet periudhës provuese që zgjatë gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit nga të dy palët. 3. Nëpunësja/i civil, gjatë periudhës provuese nuk mund të transferohet dhe nuk mund të marrë pjesë në komisione që themelohen nga institucionet për të cilat kërkohet përvojë profesionale”,* rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se në këtë rast anëtares e komisionit A. I. dhe V. K. nuk kanë mundur të jenë pjesë e komisionit të pranimit ngase janë në periudhë provuese.

Si rrjedhojë, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji konstaton se, vendosja e kriterëve të konkursit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, ndryshimi i klasës së pozitës dhe koeficientit të pagës si dhe përbërja e komisionit të pranimit, ka bërë që kjo procedurë e rekrutimit të zhvillohet në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar se: *“1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese”,* dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht duke qenë se shkeljet janë evidentuar që nga shpallja e konkursit dhe se komisioni për pranim përgjegjës për vlerësimin profesional të kandidatëve për pranim në shërbim civil është në kundërshtim me vetë ligjin bazik, atëherë çdo veprim tjetër procedural i ndërmarr në këtë procedurë është juridikisht i pavlefshëm, dhe Kolegji nuk është lëshuar në pretendimet e tjera të ankueses për shkelje procedurale dhe materiale, sepse të njëjta nuk do të kishin ndikim për vendimmarrje tjetër.

Kështu që, për sa me sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Divizioni për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, është i obliguar që në pikëpamje të dispozitivit dhe arsyetimit të këtij

vendimi të ndërmarr veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, thënë si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVS**  
**Lënda me numër A.nr.603/2025**

**Atdhe Gashi**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankueses M.D-K.*
- *Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*